



Strehëza për
gra dhe vajza
të abuzuara

ÇESHTJET THEMELORE

- Pse është i nevojshëm zbatimi i dënimit alternativ?
- Përparësitë e dënimeve alternative.
- Ligji për Shërbimin e Provës.
- Informacion mbi OJF-të që do të kontribuojnë për zbatimin e dënimit alternativ.

PËRMBAJTJA

- Informacion i përmbledhur rreth projektit.
- Shkurtimisht mbi Ligjin e Provës
- Pse kemi nevojë për dënimin alternativ?
- Organizata Evropiane e Shërbimit të Provës
- Shërbimi i Provës në vendin tonë
- Histori personale e një përdoruesi droge
- OJF-të përgjegjëse për zbatimin e projektit

Rrjeti për zbatimin e dënimeve alternative

Rrjeti për zbatimin e dënimeve alternative

Newsletter 1 Prill 2010

Si lindi projekti? Objektivat, aktivitetet

Projekti financohet nga Komisioni European, Qendra Europiane për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut. Qëllimi kryesor i projektit është të mbështesë Shërbimin e Proves në zbatimin e dënimeve alternative në Shqipëri duke ofruar programe trajtimi për të pandehurit në komunitet. Shërbimi i Proves mbështetet në gjetjen, stimulimin dhe shfrytëzimin efektiv të partneriteteve duke rritur kështu besueshmërinë në publik mbi rolin e komunitetit në dhënien efektive të dënimeve alternative.

OBJEKTIVAT E PROJEKTIT :

Krijimi i një rrjeti për Shërbimet e Komunitetit për të pandehurit;

Ofrimi i trajtimeve, rehabilitimit dhe programet këshilluese për të pandehurit në komunitet.

Ndërtimi i kapaciteteve për realizimin e aktiviteteve për Shërbimin e Proves në bashkëpunim me shërbimet e komunitetit dhe menaxhimi efektiv i burimeve të komunitetit.

Aktivitete në kuadër të partneriteteve me qëllim përmirësimin e besueshmërisë dhe angazhimit të komunitetit në sistemin e drejtësisë.

AKTIVITETET E PROJEKTIT

Krijimi dhe menaxhimi i një rrjeti për shërbimet e komunitetit për të pandehurit.

- Zhvillimi dhe implementimi i programeve specifike për të pandehurit në komunitet.
- Kapacitetet ndërtuese të Shërbimit të Provës.
- Kapacitetet Ndërtuese të Anëtarëve të Rrjetit.
- Shkëmbimi i Informacionit.
- Ndërgjegjësimi i publikut mbi Dënimet Alternative.



Z. Arben Sefgjini,
Drejtor i Përgjithshëm
i Shërbimit të Provës



Ligji për Shërbimin e Provës

SHËRBIMI I PROVËS

(Shtuar me ligjin nr. 10024, datë 27.11.2008)

Shërbimi i provës është organi shtetëror, që mbikëqyr zbatimin e dënimeve alternative, paraqet informacion dhe raporte para prokurorit ose gjykatës, sipas këtij ligji dhe ndihmon në ekzekutimin e dënimit alternativ, si dhe ndihmon personin e dënuar në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social.

Organet shtetërore qendrore dhe organet e njësive të qeverisjes vendore

i japin shërbimit të provës ndihmën e nevojshme për përmbushjen e detyrave ligjore. Shërbimi i provës bashkëpunon me OJF-të dhe shërbimin e ndërmjetësimin, në bazë të rregullave të hollësishme, të përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë.

Shërbimi i provës ndihmon personin e dënuar në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social, duke vendosur kontakte me familjen dhe mjedisin shoqëror të të dënuarit, me organizatat jofitimprurëse dhe individët.

Pse është i nevojshëm zbatimi i dënimit alternativ?



Zbatimi i dënimit alternativ në Shqipëri, i ofruar nga Zyra e Shërbimit të Provës, synon të konsolidojë dhe promovojë të drejtat e njeriut, të zgjerojë përfaqësimin e interesave dhe nevojave të ndryshme të shoqërisë, të kontribuojë në zhvillimin dhe emancipimin e shoqërisë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e komunitetit në procese të rëndësishme institucionale, parametra të domosdoshme për cilësinë e një demokracie në zhvillim. Ndër objektivat e synuara mund të rendisim:

- Krijimin e një mundësie të dytë për të pandehurit që paraqesin probleme të varësisë me drogën dhe alkoolin, probleme

të sjelljes, të personalitetit, të agresivitetit dhe të menaxhimit të zemërimit.

- Trajtimin e duhur mjekësor, psiko-social me qëllim rehabilitimin e tyre.
- Integrimin e tyre në shoqëri që do të mundësohet në bashkëpunim me institucionet përkatëse si Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrisë së Arsimit (sigurimi i kurseve profesionale, shkollimi, punësimi dhe strehimi)
- Krijimin e besueshmërisë tek publiku i gjerë mbi efikasitetin e zbatimit të dënimit alternativ në Shqipëri.
- Institucionalizimin e dënimit alternativ në Shqipëri.

“Zbatimi i dënimit alternativ në Shqipëri, i ofruar nga Zyra e Shërbimit të Provës, synon të konsolidojë dhe promovojë të drejtat e njeriut”

Pse Pro dënimeve alternative?

Dënimet alternative zvogëlojnë probabilitetin e rikthimit në rrethin e krimit.

Dënimet alternative i kushtojnë më pak taksapaguesve.

Dënimet alternative ofrojnë një mundësi për të zhdëmtuar dëmin dhe viktimën.

Dënimet alternative zhdukin “Shkollën e krimit në burg”. Dënimet alternative shmangin marrjen e kulturës së burgut, në mënyrën e të

jetuarit, të të shprehurit dhe zakonet e ndryshme që fitohen gjatë qëndrimit në burg.

Dënimet alternative ndihmojnë në mbajtjen e lidhjeve familjare dhe sociale.

Dënimet alternative i japin të dënuarit një mundësi për t'u ri-integruar në shoqëri;

Dënimet alternative eliminojnë stigmën e dënimit me burgim. Turpi i të qenit në burg është kaq real, sa dhe anëtarët e pafajshëm të familjes e vuajnë atë edhe më

shumë se vetë i dënuari;

Komuniteti përfiton nga anëtarët e tij të rregullt dhe që kanë një plan të qartë për jetën. Ky plan përfshin pjesëmarrjen në jetën ekonomike, një punë të rregullt dhe i japin një kontribut konkret komunitetit në vend të krijimit të problemeve.

Financiarisht dënimet alternative kanë më pak shpenzime krahasuar me mbajtjen në institucion të të dënuarit.

Organizata evropiane e Shërbimit të Provës (CEP)



CEP, Konferenca Evropiane për Shërbimin e Provës është një organizatë që operon në nivel evropian. Qëllimi i saj është të mundësojë përfshirjen e të pandehurve në komunitet përmes zbatimit të dënimit alternativ që zbatohet nga Zyra e Shërbimit të Provës, shërbimi i komunitetit, ndërmjetësimit dhe këshillimit.

Në fokusin e saj kjo organizatë ka nxitjen e profesionalizmit të Shërbimit të Provës, në nivel kombëtar dhe evropian.

CEP promovon bashkëpunimin evropian për çështje të rëndësishme të Shërbimit të Provës nëpërmjet

organizimit të konferencave.

Në këtë mënyrë ndikon pozitivisht në zhvillimin dhe zbatimin e dënimit alternativ. Anëtarët e saj janë organizatat që punojnë për Shërbimin e Provës dhe grupe interesi. CEP bashkon praktikantë, menaxherë, akademikë, ekspertë dhe përfaqësues të Sistemit të Drejtësisë dhe Shërbimit të Provës nga e gjithë Europa.

Së bashku ata përfaqësojnë një rrjet ekspertësh që kontribuojnë për trajtimin e të pandehurve në komunitet.

Interesi i tyre i përbashkët është mbrojtja e shoqërisë nga kostoja që përfaqëson institucioni i burgut.

Shërbimi i Provës

Pjesë e sistemit të drejtësisë penale shqiptare

Shërbimi i Provës, institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, ka filluar funksionimin e tij në Qershor të 2009-ës dhe deri më tani ka mbikëqyrur dhe mbështetur zbatimin e dënimeve alternative për më shumë se 1.000 persona.

Aktualisht Shërbimi i provës ka 4 zyra vendore, përkatësisht në Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier të cilat mbulojnë territorin shqiptar.

Stafi angazhohet në përgatitjen e raporteve të vlerësimit para dhe pas gjyqimit duke vlerësuar prejardhjen shoqërore, kushtet familjare dhe planet konkrete për

ri-integrimit shoqëror si dhe realizon mbikëqyrjen e të dënuarve me dënime alternative me qellim mbrojtjen e interesave publike dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale.



Ky shërbim kryen kontroll mbi të dënuarit dhe vepron si mburojë për komunitetin.

Përparësitë e dënimeve alternative

Nga njëra anë u jep mundësinë autoreve të veprave penale të cilët kanë mundësi për ri-integrimit dhe rehabilitim në shoqëri të rifillojnë më shpejt jetën në komunitet ndërsa nga ana tjetër kontrollojnë dhe ndëshkon autorët e veprave penale duke vepruar si mburojë për komunitetin. Sigurisht për të arritur rezultate të kënaqshme veprohet në bashkëpunim me shërbimet lokale sociale dhe të mirëqenies për të nxitur dhe rritur mundësitë e rifshirjes në shoqëri.

Për këtë qëllim është nënshkruar një memorandum bashkëpunimi mes Drejtorisë së Shërbimit të Provës dhe Shoqatave Partnere të projektit. Sipas këtij bashkëpunimi Zyra e Shërbimit të Provës i dërgon Shoqatave Partnere një letër reference me të dhënat e të pandehurit, subjekt për dënimin alternativë i cili trajtohet në qendrat ditore të këtyre shoqatave partnere, që disponojnë programe të natyrës rehabilituese, përfshirëse dhe riintegruese për të pandehurit në komunitet.

“Për këtë qëllim është nënshkruar një memorandum bashkëpunimi mes Drejtorisë së Shërbimit të Provës dhe Shoqatave Partnere të projektit.”

Historia personale

Genti, 29 vjeç, përdorues heroine prej 16 vitesh. Ai vjen nga një familje e divorcuar. Ka filluar të eksperimentojë me substanca narkotike që në moshën 13-vjeçare. E ka nisur me hashash. Me kalimin e kohës çdo fundjavë filloi të merrte rregullisht heroinë me hundë. Vjen nga një familje e divorcuar, prindërit janë ndarë kur Genti ishte 14 vjeç, ka përjetuar trauma dhe dhunë fizike e psikike të ushtruar nga i ati dhe si pasojë të gjitha këto kanë lënë gjurmë në karakterin e tij. Aktualisht jeton me gjyshërit, nga ana e së ëmës, të cilët jetojnë vetëm me pensionet e tyre. E vetmja rrugë për të gjetur paratë për të blerë mallin për Gentin ishte vjedhja. Fillimisht ka shitur të gjitha gjërat e shtrenjta që e ëma kishte në shtëpinë e tij pastaj ka filluar të vjedhë.

Gjithë këto vite është përpjekur të lërë heroinën, por ka rezultuar pa sukses. Aktualisht sapo ka dalë nga burgu me dënim alternativ, ku do t'i duhet të paraqitet në një qendër rehabilitimi nën vëzhgimin e Shërbimit të Provës. Ai është dënuar me burg, me akuzën e veprës penale për shitje dhe riprodhim të lëndëve narkotike. Ka kryer 1 vit e 3 muaj burg dhe në dy vitet e ardhshme do t'i nënshtrohet dënimin alternativ. Ai ndihet i motivuar për të dalë nga kjo gjendje, ku ndodhet. Aktualisht merr çdo ditë terapine me metadon. Ai mendon shumë edhe për të ardhmen e tij. Fillimisht është i shqetësuar për të gjetur një vend pune pavarësisht se e shikon pak të largët ditën, për shkak të diskriminimit që ekziston ndaj përdoruesve të drogës.





Aksion Plus

Shoqata Aksion Plus është themeluar në vitin 1992 nga një grup vullnetarësh, studentësh me qëllim të parandalonin përhapjen e HIV/SIDA në Shqipëri, në grupet e të rinjve dhe në grupe të tjera të rrezikuara.

Qëllimi i shoqatës është të sensibilizojë popullatën dhe rininë mbi problemet sociale duke promovuar parandalimin e HIV/SIDA, IST dhe droga duke përfshirë zvogëlimin e demit, terapi me metadon për

përdoruesit e drogës dhe shërbime të tjera sociale.

Drejtimet kryesore të aktivitetit të shoqatës janë:

Parandalim, edukim dhe komunikim – edukim bashkëmohatar nga psikologë dhe punonjës socialë në lidhje me HIV/SIDA/droga/shëndeti riprodhues, për të rinjtë e shkollave të mesme dhe sensibilizim i popullatës.

Trajtim dhe shërbime për përdoruesit e drogave. Hartimi dhe zbatimi e një programi në zvogëlimin e rreziqeve që ka përdorimi

i drogave.

Ndërtim kapacitetesh dhe avokaci. Trainerët e Aksion Plus zhvillojnë trainime me nxënës, studentë të Shkencave Sociale, vullnetarë, mësues, policë, prindër dhe ndihmëdhënës të tjerë.

Publikime, studime. Aksion Plus është një organizatë e specializuar në botimin e Manualeve të Trainimit, posterave, broshurave, fletëpalosjeve dhe materialeve të tjera informuese.

“Qëllimi i organizatave partnere është të bashkërendojnë ekspertizën e tyre në zbatimin e dënimit alternative”

Shoqata “Përthyerje”

Misioni i organizatës është të garantojë të Drejtat e Njeriut për personat që janë në konflikt me ligjin, të mundësojë përdorimin e dënimeve alternative dhe të kontribuojë në uljen e kriminalitetit nëpërmjet programeve të rehabilitimit dhe ri-integrimit.

Kjo organizatë jofitimprurëse është e përbërë nga profesionistë të ndryshëm që në interesat e tyre kanë parandalimin e kriminalitetit dhe rehabilitimin e personave të dënuar. “Përthyerja” është krijuar në vitin 1999 nga studentë dhe anëtarë të profesioneve të ndryshme që i bashkonte

dëshira për të kontribuar në shoqërinë shqiptare. Kjo organizatë është regjistruar zyrtarisht në gjykatë në vitin 2000.

Që nga ky vit “Përthyerje” ka qenë shumë aktive në projekte të ndryshme që kanë synuar të vënë në jetë misionin dhe qëllimet e organizatës.

Strehëza për gra dhe vajza të abuzuara



“Strehëza për gra dhe vajza të abuzuara” është hapur në 1998 si pjesë e “Rrjetit Kombëtar kundër Dhunës Gjinore dhe Trafikimit Njerëzor”, dhe si një projekt i shoqatës së grave “Reflexione”. Që nga ajo kohë Strehëza ka funksionuar rregullisht duke u bërë një partner aktiv në fushën e të drejtave të grave. Strehëza ka ofruar shërbime direkte për viktimat e dhunës në familje

si dhe është përfshirë në lobim, advokaci, studime dhe edukim të publikut të gjërë në të njëjtën kohë.

Misioni kryesor:

Të mbështesim viktimat e dhunës familjare nëpërmjet këshillimit, fuqizimit, edukimit dhe ndërgjegjësimit për të bërë të mundur që ato të jetojnë një jetë të sigurt dhe të ndershme.